

20vite

INOVACION DHE
SUKSES

PROFESSIONAL[®]
alarm



KATALOGU I BRENDEVE

SISTEME INTELEGJENTE TË SIGURISË

PËR NE

Zgjedhja më e mirë për sigurinë tuaj!

Professional Alarm, është ndërmarrje profesionale që për veprimtari kryesore ka furnizimin, shitjen, instalimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të sigurisë elektronike, duke përfshirë këtu edhe sistemet për menaxhimin e objekteve (Building Management System-BMS ; KNX) dhe sistemet për shtëpi inteligjente të ashtuquajturat Smart Home.

E themeluar më 2003, me ambicie të mëdha dhe duke lëvizur me hapa të sigurtë, gjithmonë duke u mbështetur në shërbime sa më kualitative dhe, duke investuar në stafin e saj që të jetë sa më profesional, i ka mundësuar Professional Alarm që sot të jetë ndërmarrja më e suksesshme e llojit të vetë në tregun Kosovor. Professional Alarm, sot është prezente me njësitë e saj në Prishtinë, Fushë Kosovë dhe Prizren. Jemi shumë krenar se sa shumë kemi arritur në këto 20 vite, nga nje kompani e vogel kemi mbërritur te jemi kompania më me reputacion në vend e edhe më gjerë.

Professional Alarm, angazhohet që çdo herë të sjellë produktet më inovative nga lëmitë e sigurisë elektronike dhe me këtë t'i mundësoj vetes, por edhe partnerëve të saj një zhvillim paralel me vendet e zhvilluara evropiane nga lëmitë e ngjashme.



Përzgjedhja me një kujdes të veçantë, e prodhuesve dhe produkteve janë shtylla jonë më e fortë. Përkrahja e madhe, që na ipet nga prodhuesit në fushën e trajnimeve profesionale dhe çertifikimeve, na mundëson të ecim përpara të sigurtë, duke i përcjellur këto njohuri përherë partnerëve tanë dhe duke i zbatuar ato me përpikëri tek klientët tanë.

Me respekt të veçantë,
Professional Alarm



PËRMBAJTJA

HIKVISION	04 - 17	JABLOTRON	28 - 29	DSPPA	40
<ul style="list-style-type: none">• Sisteme të kamerave• Kontrolli qasjes• Sisteme të alarmit ndaj thyerjes• Videofonia• Hikvision Parking Solution• Video TV Monitora		<ul style="list-style-type: none">• Sisteme të alarmit ndaj thyerjes		<ul style="list-style-type: none">• Sisteme profesionale të zërimit dhe evakuimit	
MOBOTIX	18 - 19	AMC ELETTRONICA	30 - 31	MOBILE RADIO	41
<ul style="list-style-type: none">• Sisteme të kamerave të sigurisë		<ul style="list-style-type: none">• Sisteme të alarmit ndaj thyerjes		<ul style="list-style-type: none">• Sisteme profesionale të radio komunikimit	
ANVIZ	20 - 21	URFOG	32	GPS SYSTEM	42
<ul style="list-style-type: none">• Kontrolli Qasjes		<ul style="list-style-type: none">• Teknologjia me mjegull UR Fog		<ul style="list-style-type: none">• Sistemet i kompletuar i pajisjeve GPS	
ROGER	22	AMERSEC	33	SISTEMI I BARRIERAVE	43 - 45
<ul style="list-style-type: none">• Kontrolli Qasjes		<ul style="list-style-type: none">• Sisteme profesionale kundër vjedhjes së artikujve		<ul style="list-style-type: none">• Barriera & sisteme për menaxhimin e parkingjeve• Barrierat Rrugore• Automatizimi i deryeve• Bollards, Tripods, Road Blockers	
ASSA ABLOY	23	KENTEC ELECTRONICS	34	RRJETA DHE IP TELEFONI	46 - 47
<ul style="list-style-type: none">• Zgjidhje të avancuara për menaxhimin e hoteleve		<ul style="list-style-type: none">• Sisteme të detektimit dhe alarmit të zjarrit		<ul style="list-style-type: none">• IT Ormana, Switches, Kabllo dhe Konektorë	
SMART HOTEL	24 - 25	HOCHIKI	35	AKSESORË	48 - 49
<ul style="list-style-type: none">• Sisteme për menaxhim të hotelit		<ul style="list-style-type: none">• Sistemet e detektimit ndaj zjarrit		<ul style="list-style-type: none">• Të gjitha llojet e kabllove• Bateri të kualitetit të lartë• Aksesorë të ndryshem	
LOXONE	26 - 27	UNIPOS	36	INSTALIMI DHE MIRËMBAJTJA	50
<ul style="list-style-type: none">• Sisteme për shtëpi të zgjuar		<ul style="list-style-type: none">• Sistemi i alarmit të zjarrit		<ul style="list-style-type: none">• Instalimi Professional i sistemeve të sigurisë	
		MINIMAX	37		
		<ul style="list-style-type: none">• Sisteme për mbrojtje ndaj zjarrit			
		DSPA.NL	38		
		<ul style="list-style-type: none">• Sisteme inovative të shuarjes ndaj zjarrit			
		SECURITON	39		
		<ul style="list-style-type: none">• Sistem për mbrotje nga zjarri me rreze infra të kuqe			



Kualiteti i lartë, shumëllojshmëria e madhe e produkteve dhe ofrimi i zgjidhjeve deri tek ato më të ndërlikuarat, siç është inteligjenca artificiale, e karakterizojnë HIKVISION-in dhe e veçojnë dukshëm nga të tjerët.

CAMERA SYSTEMS

- IP Camera
- ColorVu Technology
- Acusense
- Deep Learning
- Thermal Cameras
- Turbo HD X
- Digital Video Recorders
- Network Video Recorders

ACCESS CONTROL PRODUCTS

- Face recognition
- Finger Print
- Card Reader

PARKING SOLUTION

- Hikvision Parking solutions

ALARM SYSTEM

- AX Hub Pro
- AX Hybrid PRO

VIDEO DOOR PHONE

- Gen2

WALL DISPLAYS

- LCD Video Wall Displays



SMART IP KAMERA

Paraqitja e video imazheve me cilësi të lartë

Sistemi i kamerave Smart IP është sistemi më i popullarizuar i videovëzhgimit, që njëherit edhe paraqet një sistem të decentralizuar që, mundëson qasje dhe kontroll nëpë secilën paisje veç e veç. Sistemi i kamerave Smart IP ka një teknologji të integruar dhe të veçantë.



Pamje me ngjyra edhe në errësi të totale

Me teknologjinë Hikvision ColorVu, hapsirat e errëta nuk janë më një problem për sigurinë. Lentet më të mira, sensorët më të përparuar dhe ndriçimi i butë plotësues bashkohen për të ju ofruar cilësinë e imazhit me kualitetin më të lartë, madje edhe në errësi të totale.



Detektim i saktë dhe minimizimi i alarmeve të rrejshme

Seria e kamerave IP AcuSense, ju ofron një mori funksionesh ineteresante, përpos tjerash filtron alarmet dhe ju bënë të ndiheni shumë më te sigurtë. Në mënyrë të filtruar do të pranoni vetëm pamjet e shkatuara nga ndonjë alarm.



FACE RECOGNITION

Karakteristikat kryesore të deep learning

Njohja e fytyrës është vetëm fillimi i AI që njihet si “Deep Learning” nga Hikvision, që Hikvision e ka lansuar i pari nga të gjithë konkurrentët. Me një analitikë shumë ndihmuese për të menaxhuar me shpejtësi ndodhitë dhe me saktësi automatike të alarmit mbi 95%, kjo teknologji është një hap përpara dhe përtej mbikëqyrjes së videovëzhgimit. Teknologjia e “Deep Learning” nga Hikvision filtron objekte dhe lëvizje të parëndësishme në një skenar që do të shkaktonin probleme me alarme të rrejshme.

DEEP LEARNING

Rritja e sigurisë dhe efikasitetit operacional me teknologjinë Deep Learning

Deep learning është një lloj i mësimit nga vetë paisjet, e cila e mëson paisjen të ndërmerr aksione vetvetiu, si p.sh. të dalloj të folurit, të klasifikoj imazhe, të detektoj objekte apo edhe të përshkruaj një përmbajtje. Shembull nga jeta reale është asistenti virtual sikur që është: Siri dhe Cortana të cilat janë të integruara pjesërisht në “Deep Learning”. Zgjidhjet Smart Pro IP përfshijnë një gamë të gjerë produktesh për aplikime profesionale. Të përmirësuara me teknologjitë inteligjente, Hikvision kamerat inteligjente, IP dhe ato PTZ, kamera për aplikime të veçantë, kamera me shumë sensorë PanoVu, zgjidhje termike. Sistemi qendror i menaxhimit HikCentral, HikCentral Pro dhe NVR të zgjuar e produkte tjera të serisë Deep Learning e bëjnë prodhuesin Hikvision shumë të veçantë.



95%

Ngjajshmëri





SERIA E KAMERAVE TURBO HD X

Një seri inteligjente kamerash me çmim shumë ekonomik

Rimendoje sistemin tuaj të instaluar, seria e kamerave TURBO HD X, është një seri inteligjente kamerash me çmim ekonomik. Ju mundëson mbrojtje aktive, përgjegje të integruar dhe alarmim në kohë reale. Këto lloj kamerash kur e detektojnë një thyerje perimetri, alarmon në aplikacionin e shfrytëzuesit dhe jep një alarm direkt, duke i ndezuar dritat me ngjyrë kuç-kaltërt dhe ndezë sirenën që të frikësojë e parandalojë keqërsit.

PRODUKTET TERMALE

Ndërgjegjësim inteligjent, në çdo moment, në çdo gjendje

Kamerat termike të sigurisë së Hikvision përdorin detektorë termikë të përparuar që ofrojnë performancë të shkëlqyeshme të imazhit me një efikasitet të lartë. Ato janë ideale për zbatim 24/7, mund të zbatohen për të monitoruar edhe temperaturën e paisjeve kritike si: trafostacione, data center, ambiente ku temperatura mund të jetë element kritik dhe i rëndësishëm.





NETWORK VIDEO RECORDER

Video regjistruar, me ruajtje kualitative dhe të sigurt të të dhënave

Me analitikë të integruar, NVR-të e Hikvision, ofrojnë një gamë të gjërë zgjidhjesh për nevoja të ndryshme të klientëve. NVR-të janë të paisura me AI chipa dhe me algoritme shumë precize për ruajtjen e të dhënave. Këto pajisje të avansuara (NVR) sjellin me vete aplikacione shumë të fuqishme për nevoja të ndryshme. Smart Pro NVR mbështet regjistrimin me rezolucion të lartë deri në 16 MP e më shumë, dalje me kualitet ultra të lartë (UHD) deri në 8K, kapacitet ruajtje deri në 288 TB dhe kompresim video H.265 +pro për të rritur hapësirë të arkivimit deri në 70 përqind.

REGJISTRUES DIGJITAL I VIDEOVE - DVR

Cilësi superiore të imazheve dhe veçori më inteligjente në botën analoge.

DVR Turbo HD të Hikvision janë të ndara në 5 seri kryesore që ofrojnë veçori dhe aftësi të ndryshme. Pavarësisht nëse jeni duke përdorur një sistem të sigurisë analog apo duke instaluar një sistem të ri, do të gjeni një sërë zgjedhjesh të përshtatshme për nevojat e juaja.





FACE RECOGNITION
TERMINALS



FINGERPRINT
TERMINALS



PRO SERIES CARD
TERMINAL



KONTROLLI QASJES DHE MENAXHIMI I ORARIT TË PUNËS

Hikvision një emër shumë i anvsuar i Kontrollit të Qasjes dhe menaxhimit të Orarit të punës

Hikvision është një emër i veçantë në zgjidhjen e nevoja tuaja për kontrollin e qasjes dhe menaxhimit të orarit të punës. Zhvillimi i Hikvision është duke e shtyrë industrinë në avancimin e teknologjisë në çdo pjesë thelbësore të sistemit për kontrollin e qasjes. Hikvision në këtë fushë ofronë zgjidhje me karakteristika të shumta si dhe metoda të shumëfishta në mënyrat e qasjes për konfirmim të sigurtë të identitetit si: me kartelë, gjurmë gishtërinjesh, me kod, me identifikim fytyre dhe me biometri syri, apo e kombinuar me të gjitha. Ndërsa, të dhënat e klientëve mbetën gjithmonë të sigurta dhe të enkriptuara me RSA dhe AES.



FLEXIBLE SOLUTION
FAST ACCESS

**SIMPLICITY THROUGH
INNOVATION**



SISTEMI I ALARIMIT - AX HYBRID PRO


Thjeshtësia përmes inovacionit të sistemit të alarmit AX Hybrid PRO

Inovacionet e Hikvision në mbrojtjen kundër ndërhyrjeve kanë arritur një fazë të re me lançimin e gjeneratës së ardhshme AX Hybrid.

Sistemi i alarmit PRO. Duke trashëguar dizajnin elegant të AX PRO origjinal dhe të ngulitur me teknologji të fundit, Seria AX Hybrid PRO ofron kombinimin unik të mbrojtjes së besueshme me tela me fleksibilitet të zgjeruar dhe pa probleme për integrimi të pajisjeve pa tela (Wifi).

Duke plotësuar nevojat më të ndërlikuara të skenarëve të shtëpisë dhe biznesit, Seria AX Hybrid PRO është krijuar për të mbrojtur dyqane të vogla, zyra dhe ndërtesa banimi nga vjedhjet, grabitjet, zjarri dhe përmbytjet, me verifikim të menjëhershëm dhe vizual të alarmit për siguri reale.

- **Fleksibilitet i zgjeruar me performancë të shkëlqyer**
- **Qëndroni të informuar me verifikimin vizual në kohë reale**
- **Mbrojtje gjithëpërfshirëse me sinergjinë e zbulimit me tela dhe pa tela**
- **Sistemi i hapur dhe konvergjent në dorë**





VERIFIKIM EFEKTIV ME FLEKSIBILITET TË ZGJERUAR



MBROJTJE GJITHËPËRFSHIRËSE ME KABLO DHE ME WIRELESS



BESUESHMËRI E MADHE KU MUND TË MBËSHTETENI GJITHMONË



SISTEMI I HAPUR DHE KONVERGJENT NË DISPOZICION



HIKVISION - AXPRO 2


Sistemi i alarmit AXPRO

Sistemi i alarmit të thyrje-vjedhjes nga Hikvision, një produkt shumë kualitativ dhe me shumë funksione interesante për zbatime të përditshme. I programueshëm direkt nga telefoni mobil, dhe lehtë i modifikueshëm nga vetë klienti. Hikvision ofron një gamë të gjerë produktesh alarmimi për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm, integron edhe detektorët e tymkit/zjarrit, video verifikim dhe CCTV kamera, të cilat menaxhohen nga një aplikacion. Sistemi i alarmit AX PRO, është zgjidhje ideale për: zyre, shtëpi, villa, banesa, dyçane, depo etj.. Aplikacioni falas.



Hik-Connect dhe Hik-ProConnect, zgjidhje për smartphone dhe web për konsumatorët, instaluesit dhe integruerit.

Duke siguruar një kontroll si kurrë më parë mbi pajisjet e instaluar, Hik-Connect me AXPRO siguron qasje të pashembullt të përdoruesit në sistemet e sigurisë. Hik-ProConnect u jep instaluesve një platformë krejt të re për të kontrolluar pajisjet e instaluar të sistemeve të sigurisë. Nga distanca, nga kudo që keni qasje interneti, ju mund të mirëmbani të gjitha pajisjet e instaluar. Hik-Connect dhe Hik-ProConnect, bashkon të gjithë portofolin e produkteve të Hikvision në një vend, duke sjellë vlerë superiore për instaluesit, integruerit dhe përdoruesit në veçanti. Një platformë unike, me përdorim shumë të lehtë.





VIDEO DOOR PHONE

Sistemi i zakonshëm i interfonisë, thjesht nuk është i mjaftueshëm.

Teknologjia e sotme ka aftësinë për ta bërë komunikimin më njerëzor dhe më personal se kurrë më parë. Sistemi i videofonise Hikvision e rritë elementin njerëzor të komunikimit - duke ju mundësuar komunikuesve të shohin njëri tjetrin. Por kjo nuk është e gjitha. Sistemet e videofonisë nga Hikvision kanë një listë të karakteristikave inteligjente, që thjesht mund të ju befasojnë. Qasje dhe komunikim nga kudo që jeni, njoftim në kohë reale për praninë e vizitorit, monitorim dhe hapje e derës qoftë lokalisht apo nga distanca, integrim i sensorëve të ndryshëm në të njëjtin sistem. Porosi automatike për postën apo vizitorin. I lehtë për instalim dhe mirëmbajtje. Sistem i zgjerueshëm modular.



2-wire Version



Standard PoE
(IP Version)



Link with Alarm Sensors



32 GB SD Card



User-friendly Interface



Touch Screen
with 1024 * 600 Resolution





P A R K I N G



HIKVISION PARKING

Sistem i parkimit inovativ, i sigurtë dhe efikas

Hikvision ofron zgjidhje efikase të menaxhimit të parkingjeve, qoftë ato me pagesë automatike dhe pa pagesë. Mundëson gjetjen e shpejtë të vendit të lirë, mbikëqyrë veturën përgjatë kohës së parkimit edhe ndaj thyerje-vjedhjes, apo gërvishtjes. Mundëson hyrjen dhe daljen nëpërmes të targave të automjetit, kartelës si dhe nëpërmes të telefonit mobil. Softueri për menaxhimin e parkimit mundëson një gjenerim të shpejtë të raporteve të ndryshme.



DETEKTIMI I AUTOMJETIT

Posa automjeti futet në zonën detektuese, sistemi merr targat dhe i mundëson të hyjë në zonën e parkimit.

REGJISTRIMI I TABELAVE TË AUTOMJETIT

Informacioni i automjetit do të regjistrohet, si p.sh. informacionet e licencës, fotografitë dhe pamjet video, dhe do të krahasohen me listën e bllokimit / listën e lejeve për të aktivizuar njoftimin.

EKRANI I INFORMACIONIT TË PARKIMIT

Në ekran do të shfaqen informacione të personalizuara si mesazh i mirëseardhjes, data, ora, sa vende të lira janë dhe ku janë.


BARRIERE E SHPEJTË DHE INTELEGJENTE

Barrierat e Hikvision janë të dedikuara për operime të shpejta dhe efikase, për numër të madh të trafikut ditor.



**Për më shumë reth
produkteve dhe brendeve
tona na vizitoni në uebfaqën:**

Professionalalarm.eu





TV VIDEO WALL DISPLAYS

Jepi fuçi dyqanit tuaj me video panela të murit

Hikvision ofron zgjidhje totale të ekraneve dhe kontrollit me ekranet bashkuese LCD dhe ekranet LED, pa ndërprerje, që japin imazhe kualitative. Ekrane me efikasitet të lartë. Ju mund të zgjidhni midis përmbajtjeve të ndryshme për t'u shfaqur në kontrolluesin e fuqishëm të video-murit duke përdorur skenarë të paracaktuar, të gjitha nga një tablet celular apo duke u qasur nga distanca. Kjo zgjidhje ka për objektivat reklamat e ndërmarrjeve, reklamat komerciale, mediat publike, qendrat tregtare dhe qindra aplikime të tjera.

KARAKTERISTIKAT KRYESORE



Transmetimi i sinjalit pa vonësë ose humbje



Modaliteti i rregullueshëm i kontrollit



Mbështet sinjalin dhe rezolucionin e shumëfishtë



Modele të shumta të imazheve për pamje të drejtpërdrejta



PROFESSIONAL
alarm

**ZGJEDHJA MË E MIRË PËR
SIGURINË TUAJ**

MOBOTIX



SISTEMET E KAMERAVE

MOBOTIX

Mobotix, është prodhues Gjerman që njëherit në botën e sigurisë njihet edhe si pioner në teknologjinë e kamerave të rrjetit apo IP Kamerave

Mobotix ofron një sistem të decentralizuar të monitorimit të kamerave me ç'rast redukton dukshëm ngarkesën në rrjet dhe mundëson një menaxhim shumë më profesional. Mobotix karakterizohet gjithashtu edhe me dizajne shumë të veçanta të kamerave, por edhe me kualitetin superior që ofron.



**M73 HIGH
PERFORMANCE IOT
CAMERA**

M73 është pionier i gjeneratës MOBOTIX 7. Sistemi video IoT vendos standardet si një paketë kompakte energjie. Fleksibël, inteligjent dhe gjithanshëm. E gjitha në traditën e kompanisë MOBOTIX. E megjithatë krejt unik.



**M16
ALLROUND DUAL**

I papërshkueshëm nga moti dhe i fuqishëm, pasardhësi i fundit i modeleve të suksesshme të kamerës M1 përmes M12 përmban module të sensorit të këmblyeshëm, si dhe teknologjinë më të fundit të sistemeve MOBOTIX.



MOBOTIX MOVE

Zgjidhja perfekte për nevoja të sistemeve me kosto standarde, është Mobotix Move

Me portofolin tonë të teknologjisë jashtëzakonisht të gjerë të kamerave MOBOTIX, ju jeni të pajisur në mënyrë të përkryer për pothuajse çdo projekt të CCTV-së dhe çdo kërkesë! Përveç programit të decentralizuar të kamerës IoT, MOBOTIX ofron gjithashtu serinë klasike të kamerave MOBOTIX MOVE të centralizuara. Kjo përfshin katër lloje të ndryshme kamerash në disa versione të hollësishme: kamerat PTZ SpeedDome, kamerat Bullet, kamerat Dome dhe kamerat hemisferike. **Cilësi gjermane!**



**I26 INDOOR 180°
COMPACT, DISCREET AND
INEXPENSIVE.**

I26 është zhvilluar posaçërisht për instalimin në mur. Falë këndit të tij të animit prej 15°, ai ofron një pasqyrë të përsosur. Një i26 i vetëm me një lente 180° monitoron një dhomë të tërë. Dizajni kompakt i kamerës siguron një pamje që nuk bie në sy në të gjitha mjediset.



**MOBOTIX CLOUD
I THJESHTË DHE I SIGURTË**

Teknologjia Cloud kompjuterike është e ardhmja — kështu që pse të mos filloni sot? MOBOTIX CLOUD është një platformë e shkathët dhe dinamike që hap mundësi krejtësisht të reja për ju ose biznesin tuaj. Hyni në sistemet tuaja video në mënyrë të përshtatshme dhe të sigurt, kudo që dëshironi, kurdo që dëshironi. Menaxhoni kamerat dhe përdoruesit tuaj me lehtësi dhe efikasitet — nga çdo pajisje, pavarësisht nëse preferoni një smartphone, tablet ose PC.



KONTROLLI QASJES



Professional Alarm, ju ofron zgjidhje të shumta për të kontrolluar dhe menaxhuar qasjen e personelit si dhe menaxhimin e orarit të punës.

Produktet e Anziv ofrojnë zgjidhje me vlerë të orientuar në siguri dhe produkte me cilësi të lartë, Anviz fokusohet në krijimin e zgjidhjeve të unifikuara që shtrihen përgjatë biometrikës, njohjes së gjurmëve të gishtërinjëve, njohjen e fytyrës dhe biometrisë së syrit (irisit), teknologjisë RFID, menaxhimin e qasjes së personelit si dhe menaxhimin e orarit të punës.



ULTRAMATCH

Sytë përmbajnë një model kompleks, janë unik dhe ndryshojnë pak gjatë jetës. Kjo e bën njohjen e syve opsionin më të saktë dhe më të shpejtë për të verifikuar personin me saktësi të madhe. Prodhimet e serisë UltraMatch kanë një dizajn elegant dhe performancë të fuqishme. Duke adoptuar algoritmin BioNANO, sistemi ofron njohjen më të saktë, më të qëndrueshme dhe më të shpejtë të syve, duke ofruar siguri të nivelit të lartë në regjistrimin biometrik, identifikim individual dhe kontrollin e qasjes.



CROSSCHEX SOFTWARE

CrossChex është një sistem inteligjent i menaxhimit të pajisjeve për menaxhimin e orarit të punës, i cili është i zbatueshëm për të gjitha pajisjet e prodhuara nga Anviz. Dizajni i lehtë dhe interaktiv, e bën këtë sistem shumë të lehtë për ta përdorur, funksionet e avancuara mundësojnë këtë sistem të realizojë menaxhimin e orarit, stafit, listën e pagave, autorizimin e qasjes dhe gjithashtu mundëson raporte të ndryshme lidhur me ngjarjet e regjistruara.



SECU365

Platforma inteligjente e sigurisë e bazuar në infrastrukturë Cloud Computing

Secu365 do të sigurojë një gamë të gjerë të mbrojtjes për një hapësirë mesatare biznesore, nga hyrja kryesore, zona e pritjes, dhoma IT dhe financiare dhe zona e Perimetrit. Ju mund të përdorni kryesisht një qendër kontrolli për të realizuar një monitorim të ndaluar të hapësirës tuaj dhe të kontrolloni gjithçka nga aplikacioni cloud. **Një zgjidhje e fuqishme me kosto të lirë.**



C2 PRO

Është një pajisje për menaxhimin e qasjes në punë, që synon tregun e mesëm dhe të lartë. Pajisur me një procesor shumë të fuqishëm Dual-Core 1GHz, C2 Pro mbanë performancë të lartë, duke përfunduar krahasimin për autorizim në më pak se 0.5 sekonda. Përkrahë modulën e lexuesit RFID (HID, ALLEGION ose ANVIZ) dhe RS485, PoE-TCP / IP ose komunikim WiFi për kërkesa të ndryshme.



FACEDEEP 3

Seri FaceDeep 3 janë terminale të ri për identifikimin me fytyrë me bazë AI i pajisur me një CPU të bazuar në Linux me dy bërthama dhe algoritmin më të fundit të të mësuarit të thellë BioNANO®. Ai përkrahë deri në 10,000 baza të dhënash dinamike të fytyrave dhe i njeh me shpejtësi përdoruesit brenda 2m (6,5 ft) në më pak se 0,3 sekonda dhe personalizon identifikimet me një shumëllojshmëri raportimesh.



MCT84M ACCESS TERMINAL

Terminal i qasjes me dizajn modern me disa opsione, me mundësi qasje: me kod, kartelë, Bluetooth, NFC dhe qasje të kombinuar. Terminalet e ROGER kçyen në BUS nëpërmes të RS485, në një kontrollor mund të kçyen deri në 32 copë (ose 64 me lexues). Përkrahje për sektorët e enkriptuar nga MIFARE® Ultralight me kartela klasike RS485 ndërlidhje me EPSO 3 protokoll Distanca e leximit deri në 7cm, 3 LED indikator, shifrador me prekje, dy butona të programueshëm.



KONTROLLI QASJES

Sistemi i kontrollit të qasjes dhe automatizimit të objekteve

Prodhuesi ROGER nga Polonia ofron një kategori të gjerë produktesh kur kërkohen zgjidhje të avancuara me protokolle të sigurta komunikimi. Kontrolli i avancuar i qasjes, i njohur gjithashtu si kontrolli i qasjes të klasës së ndërmarrjes (për kompanitë kryesishtë), është menduar kryesisht për objekte të mesme, të mëdha dhe shumë të mëdha, ku roli i sistemit të kontrollit të qasjes nuk është i kufizuar vetëm në kontrollin e trafikut të njerëzve, por është i zgjeruar edhe me shumë funksione shtesë. Sistemet e integruara më të shpeshta me sistemin e kontrollit të qasjes përfshijnë sistemin e automatizimit të ndërtesave (BMS), sistemin e alarmit të thyerjes, sistemin e mbrojtjes nga zjarri, sistemin CCTV dhe së fundmi, gjithnjë e më shpesh platformat e TI-së. **Për një sistem të sigurtë dhe afatgjatë zgjidh ROGER!**

MCT84M-BK-QB

MCT84M-BK-QB është një terminal identifikimi i dedikuar për sistemin e kontrollit të qasjes RACS 5.

Opsionale, lexuesi mund të konfigurohet në protokollin e komunikimit me stilolaps dhe përdoret në skenarë të tjerë p.sh., në sistemet e automatizimit.

Përdoruesit mund të identifikohen duke përdorur QR kodin, ID-në celulare BLE/NFC dhe me kartelë.





VingCard
Novel



reddot winner 2023

ASSA ABLOY
Global Solutions

HOTEL ACCESS & SECURITY SOLUTION

Zgjidhje të avancuara për menaxhimin e dhomave të hoteleve nga prodhuesi Suedez më me renome ASSA ABLOY.

ASSA ABLOY përherë ka qenë në krye të inovacionit në industrinë e mikëpritjes dhe të argëtimit, duke ofruar zgjidhje shumë të dizajnuara dhe të qëndrueshme për hotele dhe objekte të tjera afariste. ASSA ABLOY, ofron një varg të tërë produktesh dhe zgjidhjesh për menaxhimin e hoteleve me një dizajn jashtëzakonisht unik. Me ASSA ABLOY, Hotelit i rritet vlera, reputacioni dhe klientela.



VINGCARD NOVEL

është brava më e re e ASSA ABLOY, e shpallur edhe fituese në "Red Dot Awards" me pamjen më elegante dhe me gamën e fuqishme të funksionaliteteve të avancuara, me një dizajn krejtësisht të një teknologjie të së ardhmes.



Wing Handle



Straight Handle



Standard Handle




Functional ANSI Handle




Gothic Handle

DORËZAT ELEKTRONIKE

Duke ofruar një nga zgjedhjet më të gjera të prodhimeve të industrisë, bravat elektronike VingCard, japin mundësinë e përshtatjes në çdo dizajn të hotelit tuaj, shumëllojshmëria, koloriteti, funksionaliteti, efikasiteti dhe jetëgjatësia e këtyre bravave për investuesin kan një interes të veçantë investimi.



Polished Brass



Velour Nickel w/ Polyester



Black Titanium

Standard / optional features



Lock audit trail



Cancel guest card



Extend stay



Change rooms



Intruder alarm



Open doors



Low battery



Passage mode


Security

Operations - Maintenance




BLACKGLASS DOORBELL

Sipërfaqe e qelqit të zi me 45° dhe ikona të personalizueshme. Duke ju dhuruar një ndjenjë të këndshme të thjeshtë dhe elegante.



HOTEL CARDKEY SWITCH

Kursimi 1 Kwh në dhomë çdo ditë për një hotel me 300 dhoma do të thotë kursim 1 x 300 x 365 x 6.9 cent = € 7,555.5 euro kursime në vit!



SMART HOTEL SOLUTION

Zgjidhjet më të avansuara për menaxhim dhe digjitalizim të hotelit

Ju ofrojmë një seri produktesh për një smart hotel, nga bravat, ndërpererësat me ndjeshmëri në prekje, termostatat, paisjet jashtë dhomave e shumë elemente të tjera. Menaxho nexemjen dhe ftohjen nga recepcioni. Të gjitha të menaxhueshme nga një vend.

HOTEL DOORLOCK

Brava të dyerve dixhitale për dhoma të hotelit, me prekje touch dhe me ID kartë. Në ngjyra të ndryshme dhe kualitet të lartë.



NETWORKING THERMOSTAT

Zgjidhje e përparuar e termostatit me rrjetë S-BUS, i cili mund të kontrollojë sistemin e ajrit të kondicionuar, nxemjen & sistemin e ventilimit të ajrit.





HOTEL DOORLOCK

Brava të dyerve digjitale për dhoma të hotelit.

Brava të dyerve dixhitale për dhoma të hotelit, me prekje touch dhe me ID kartë. Në ngjyra të ndryshme dhe kualitet të lartë.

SOFTWARE

Sistemi për menaxhimin e dhomave të hotelit

Sistemi jonë i menaxhimit të Hotelit ju mundëson kursim të energjisë duke përmirësuar cilësinë e menaxhimit, sigurisë dhe kënaqësisë së mysafirëve.




LOXONE


SMART HOME

Shtëpi inteligjente në kuptimin e plotë të fjalës.

Shijoni më shumë kohë për jetën. Shtëpia inteligjente Loxone mendon si ju. Ajo njuh nevojat tuaja dhe kryen veprime sipas stinës, motit, pranisë dhe mënyrës së jetesës suaj. Shtëpia inteligjente me IQ më të lartë. Një shtëpi që do të kujdeset për mijëra veprime çdo vit, duke ju dhënë kohë për të shijuar gjërat e bukura të jetës. **Ju mund ta automatizoni çdo proces të përditshmërisë në shtëpinë tuaj përmes telefonit, laptopit apo tabletit.**



Ekosistem i plotë për shtëpi të zgjuar



Audio shërbehet më së miri e automatizuar


Kontrolloni muzikën tuaj nga telefoni juaj në secilën dhomë: të shtëpisë, hotelit, zyres apo restaurantit.





01

02



03




04



05

06




07



08



09



10



- 01 **LED Ceiling Light RGBW:** Dritat e dhomave të gjitha në një me një sensor lëvizjeje të integruar.
- 02 **LED Pendulum Slim:** Shton një rezistencë të veçantë për çdo dhomë.
- 03 **Touch Pure:** Dizajn i përjetshëm, kontroll intuitiv.
- 04 **Touch:** Gjenerata tjetër e një ndërprerësi Touch, në madhësinë më të vogël.
- 05 **Key Fob:** Çelës i enkriptuar për qasje të përshtatshme.
- 06 **Miniserver:** Truri i i shtëpisë së zgjuar - Loxone.
- 07 **Miniserver Go:** Zgjidhja inteligjente për rinovim dhe rikonstruksion.
- 08 **Remote Air:** Telekomanda wireless për kontrollin e çdo funksioni.
- 09 **NFC Code Touch:** Zgjidhja perfekte e kontrollit të qasjes.
- 10 **Music Server:** Një përvojë tjetër audio në çdo dhomë.
- 11 **Touch Surface:** Transformoni çdo sipërfaqe në një element unik kontrolli.
- 12 **Wall Speaker:** Cilësi e lartë në performancë dhe dizajn.
- 13 **Touch Nightlight Air:** Nje alarm i gjithi në një, drita e natës, burimi i dritës së ambientit dhe ndërprerësi intuitiv.
- 14 **Touch & Grill Air:** Termometri i parë në skarë që integrohet në shtëpitë e mençura.

Produkte automatizimi për shtëpi të zgjuar

